



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 330 / prot. 11

Tiranë, më 16.9.2019

Lënda: Njoftim për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë datë 20.5.2000

Z. JORGO KOKA

Adresa: Delvinë

Delvinë

Për dajeni : **AGJENCISË RAJONALE TË EKSTENSIONIT BUJQËSOR**
Adresa : Lagja "Çlirimi", Bulevardi i Palmave pranë varrezave të
Dëshmorëve

Lushnje

Me Kontratën e Qirasë datë 22.05.2000 nga Drejtoria e Bujqësisë së Rrethit Delvinë, me cilësinë e Qiradhënësit keni marrë me qira tokën bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 2 ha, parcela me numër kadastral 4/1, Zona Kadastrale 3832, bashkia Finiq, Qarku Vlorë, me qëllim kultivimin e vreshtit, për një afat 30 vjet. Çmimi i qirasë vjetore për këtë qiradhënie është në vlerën 15.000 lekë në vit.

Në Vendimin nr. 373, datë 20.06.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave procedurave dhe kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", Kreu VII "Monitorimi i kontratave", pika 6, parashikohet se "...Për përmbushjen e detyrimeve kontraktore dhe monitorimin e kontratave të lidhura nga ish-drejtoritë e bujqësisë ngarkohen agjencitë rajonale të ekstencionit bujqësor, në juridiksionin e të cilës gjendet toka bujqësore, objekt i këtyre kontratave..".

Në referim të dispozitës së sipërcituar ju kërkua informacion Agjencisë Rajonale të Ekstencionit Bujqësor Lushnje mbi përmbushjen e kushteve të kontratës së qirasë, e cila me Procesverbalin nr.51 prot, datë 6.8.2019 informon se nga monitorimi në vend i realizimit të kontratës rezultoi se sipërfaqja e marrë me qira nga ju nuk është e punuar apo e kultivuar, është djerr, si dhe se ju keni paguar rregullisht vlerën e qirasë vjetore.

Në Kontratën e Qirasë "Dispozita të veçanta", pika 3, parashikohet se "...Qiramarrësi siguron qiradhënësin që toka bujqësore, e marrë me qira do të përdoret vetëm për kultivim vreshti, pa të drejtën e përdorimit të nëntokës dhe burimeve të saj, sipas strukturës së kulturave që parashikon vetë qiramarrësi dhe do të përdorë makineri dhe pajisje të nevojshme për të trajtuar prodhimtarinë e tokës që ka marrë me qira..."; pika 4 parashikon se "...Qiramarrësi do të sigurojë vetë të gjithë bazën materiale të nevojshme për kultivimin e vreshtit në sipërfaqen e tokës bujqësore të marrë me qira...".

Neni 844 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë parashikon se "...Qiradhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës në qoftë se qiramarrësi nuk vë në shërbim të sendit mjetet e nevojshme për administrimin e tij, në qoftë se nuk zbaton rregullat teknike dhe në qoftë se ndryshon në mënyrë të qëndrueshme destinimin ekonomik të sendit..". Në zbatim të dispozitave të sipërpërmendura kjo kontratë qirajë duhet zgjidhur për mospërmbushje nga qiramarrësi i detyrimeve kontraktore të parashikuara në të.

Sa më lart, ju njoftojmë për fillimin e procedurave për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë 22.05.2000 nga Drejtoria e Bujqësisë së Rrethit Delvinë, me cilësinë e Qiradhënësit keni marrë me qira tokën bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 2 ha, parcela me numër kadastral 4/1, Zona Kadastrale 3832, bashkia Finiq, Qarku Vlorë, duke përcaktuar si datë zgjidhje datën 20 tetor 2019 dhe brenda kësaj date duhet të dorëzoni sipërfaqen e trajtuar me qira.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Enea Hoti

